



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 142 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

VENDIM Nr. 11, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të *gërmimeve klandestine të kryera në Nekropolin e Parkut Arkeologjik të Amantias*, realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të *gërmimeve klandestine të kryera në Nekropolin e Parkut Arkeologjik të Amantias*, realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë, me kushtin përkatës në vijim të kësaj pike.
2. DRKK Vlorë të realizojë mbulimin e varreve të zbuluara nga gërmimet klandestine, të kryera në Nekropolin e Parkut Arkeologjik të Amantias, me qëllim ruajtjen dhe mosdëmtimin e mëtejshëm të tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARKO FORXHI

MINISTËR



SEKRETARIA KKA

RUDINA ZOTO